

LIGJ
Nr. 38/2026

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË 7 PËR ZGJIDHJEN
E MOSMARRËVESHJEVE TË MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN
DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS
QENDRORE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9696, DATË 21.3.2007**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollit shtesë 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, ratifikuar me ligjin nr. 9696, datë 21.3.2007, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Këshilli i Ministrave miraton procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarëve të panelit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, lidhur me çështjet e mbuluara nga marrëveshja e CEFTA-s, si dhe mënyrën e shpërblimit të tyre.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.4.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 285, datë 5.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

**PROTOKOLL SHITESË 7
PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE
I MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E
TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE**

Preambulë

Palët e Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA):

1. *duke marrë parasysh* aneksin 1 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (në vijim e referuar si “CEFTA 2006”), veçanërisht nenet 42 dhe 43 të saj, si dhe aneksin 8, mbi “Emërimin e Ndërmjetësuesit” dhe aneksin 9, për përbërjen dhe funksionimin e Gjykatës së Arbitrazhit;

2. *pasi ka vendosur* të eliminojë pengesat për tregtinë brenda CEFTA-s dhe të thellojë në mënyrë progresive marrëdhëniet tregtare brenda frymës së klauzolës së Përgjithshme Evolucionare të CEFTA-s 2006, të përfshirë në nenin 45 të saj; dhe

3. *duke marrë parasysh* interesin e palëve për një qasje më të strukturuar ndaj konsultimeve, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve brenda CEFTA-s, siç parashikohet nga ky Protokoll Shtesë 7 (në vijim i referuar si ky “Protokoll”);

kanë rënë dakord, si më poshtë:

SEKSIONI I DISPOZITAT FILLESTARE

Neni 1 **Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij Protokoll, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Këshilltar” nënkupton një person fizik i cili mbahet nga një palë në mosmarrëveshje për të këshilluar ose ndihmuar atë palë në një procedurë sipas këtij Protokoll;

b) “Çdo mjet” i referohet mjeteve nëpërmjet të cilave mund të kryhen procedurat sipas këtij Protokoll, duke përfshirë takimet personalisht dhe/ose komunikimet elektronike;

c) “Asistent” nënkupton një person fizik i cili kryen kërkime ose i ofron ndihmë një paneli në një procedurë;

d) “Informacion konfidencial tregtar” dhe “informacion tepër konfidencial tregtar” nënkupton çdo informacion tregtar ose pronësor që një palë në mosmarrëveshje ose palë e tretë e ka caktuar si të tillë, pavarësisht nëse përmbahet në një dokument të dhënë nga një organ publik ose privat, sepse ai nuk është ndryshe i disponueshëm në *domenin* publik dhe zbulimi i tij, sipas pikëpamjes së palës në mosmarrëveshje ose palës së tretë, mund t’i shkaktojë dëm të jashtëzakonshëm mbajtësit të ligjshëm të informacionit. Çdo palë në mosmarrëveshje ose palë e tretë duhet të veprojë me mirëbesim dhe të ushtrojë kufizim në përcaktimin e informacionit si “konfidencial-tregtar” ose “jashtëzakonisht konfidencial-tregtar”;

e) “Kandidat” nënkupton një person fizik, emri i të cilit është në listën e anëtarëve të panelit, në përputhje me nenin 20 të këtij Protokoll ose në listën e kryetarëve të një paneli, në përputhje me nenin 21 të këtij Protokoll dhe i cili është nën shqyrtim për t’u përzgjedhur si anëtar ose kryetar i një paneli;

f) “Marrëveshja CEFTA” nënkupton “Marrëveshjen për ndryshimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore”, të nënshkruar më 19 dhjetor 2006, duke përfshirë anekset e saj dhe protokollet shtesë të Marrëveshjes CEFTA, si dhe dokumentet ligjore të bazuara në të;

g) “CEFTA 2006” nënkupton versionin e konsoliduar të “Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore” që ndodhet në aneksin 1 të Marrëveshjes CEFTA;

h) “Kryetar” nënkupton anëtarin e panelit i cili kryeson mbledhjet dhe seancat e një paneli në një procedurë;

i) “Kod i sjelljes” nënkupton rregullat e përcaktuara në shtojcën II të këtij Protokoll që zbatohen për kandidatët dhe anëtarët e panelit;

j) “Raport i pajtueshmërisë” nënkupton një raport të lëshuar nga një panel i rimbledhur në rast të një mosmarrëveshjeje për pajtueshmërinë ose ekuivalencën, në përputhje me nenin 31 të këtij Protokoll;

k) “Informacion konfidencial” nënkupton çdo informacion përveç “informacionit konfidencial tregtar” dhe “informacion tepër konfidencial tregtar” që kërkohet sipas këtij

Protokolli të trajtohet si konfidencial ose që një palë në mosmarrëveshje, ose një palë e tretë e ka caktuar si të tillë;

l) “Palë konsultuese” nënkupton një palë që merr pjesë në konsultime, në përputhje me seksionin III të këtij Protokoll;

m) “Ditë” nënkupton një ditë kalendarike, përveç rastit kur specifikohet ndryshe;

n) “Palë në mosmarrëveshje” nënkupton një palë që merr pjesë në procedurat para një paneli, duke përfshirë edhe procesin në lidhje me përbërjen e tij, në përputhje me nenin 18 të këtij Protokoll;

o) “Dokument” nënkupton një njoftim, kërkesë, parashtrim me shkrim ose çdo dokument tjetër që lidhet me një procedurë sipas këtij Protokoll;

p) “Ndërmjetës” nënkupton një person fizik që drejton një procedurë ndërmjetësimi, në përputhje me seksionin II të këtij Protokoll;

q) “Procedura ndërmjetësimi” nënkupton rregullat e përcaktuara në seksionin II të këtij Protokoll që zbatohen për procedurat e ndërmjetësimit;

r) “Palë propozuese” nënkupton një palë që krijon një listë të individëve që janë të gatshëm dhe të aftë të shërbejnë si anëtarë të panelit, në përputhje me nenet 20 dhe 21 të këtij Protokoll;

s) “Pushim zyrtar” nënkupton çdo të shtunë dhe të diel, dhe çdo ditë tjetër të caktuar nga një palë si pushim zyrtar;

t) “Palë ose palët e interesuara” nënkupton një palë në mosmarrëveshje ose palët në mosmarrëveshje dhe një palë të tretë ose palët e treta;

u) “Palë” ose “palët” nënkupton një palë ose palët në Marrëveshjen e CEFTA-s;

v) “Procedurë”, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, nënkupton një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ndërmarrë në përputhje me seksionin IV të këtij Protokoll;

w) “Përfaqësues i një pale” nënkupton çdo person fizik i cili emërohet nga një palë dhe i autorizuar sipas ligjit për të përfaqësuar atë palë në një procedurë sipas këtij Protokoll;

x) “Palë kërkuuese” nënkupton një palë që kërkon shërbime të mira ose pajtim, në përputhje me nenin 5 të këtij Protokoll, ndërmjetësim në përputhje me nenin 8 të këtij Protokoll, konsultime në përputhje me nenin 15 të këtij Protokoll ose krijimin e një paneli, në përputhje me nenin 16 të këtij Protokoll;

y) “Palë përgjegjëse” nënkupton një palë të cilës i drejtohet një kërkesë për ndërmjetësim ose konsultime, në përputhje me nenin 8 të këtij Protokoll dhe nenin 15 të këtij Protokoll ose të cilës i drejtohet një kërkesë për krijimin e një paneli, në përputhje me nenin 16 të këtij Protokoll;

z) “Rregullat e Procedurës” nënkupton rregullat e përcaktuara në shtojcën I të këtij Protokoll që zbatohen për procedurat para një paneli; dhe

aa) “Palë e tretë” nënkupton një palë të CEFTA-s të ndryshme nga palët konsulente ose palët në mosmarrëveshje.

Neni 2

Bashkëpunimi

1. Palët në çdo kohë do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të rënë dakord mbi interpretimin dhe zbatimin e Marrëveshjes CEFTA, dhe do të bëjnë çdo përpjekje nëpërmjet bashkëpunimit dhe konsultimeve për të arritur në një zgjidhje të ndërsjellë të kënaqshme për çdo çështje që mund të ndikojë në funksionimin e Marrëveshjes CEFTA.

2. Para fillimit të procedurave formale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, palët do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje të ndërsjellë të kënaqshme, duke përdorur mjetet konsultative të disponueshme brenda kuadrit të CEFTA-s.

3. Palët mund të vazhdojnë të përdorin mjete të tilla konsultative, ndërsa bëhet zgjidhja formale e mosmarrëveshjeve, me synimin për të arritur një zgjidhje të ndërsjellë të kënaqshme të mosmarrëveshjes.

Neni 3 Fushëveprimi

Ky Protokoll do të zbatohet për çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes CEFTA.

Neni 4 Zgjedhja e forumit

1. Kur një palë ka filluar procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas këtij Protokolli, ajo nuk mund të fillojë procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas një marrëveshjeje tjetër tregtare ndërkombëtare në të cilën palët në mosmarrëveshje janë palë, duke përfshirë Marrëveshjen e OBT-së, në lidhje me të njëjtën çështje, përveç rasteve kur paneli i krijuar sipas këtij Protokolli, për arsye juridiksionale ose procedurale, të ndryshme nga përfundimi i procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 25 të këtij Protokolli, nuk mund të nxjerrë përfundime mbi atë mosmarrëveshje.

2. Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij Protokolli konsiderohen se janë nisur me kërkesën e një pale për krijimin e një paneli sipas nenit 16 të këtij Protokolli.

3. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas Marrëveshjes së OBT-së konsiderohen se janë nisur me kërkesën e një pale për krijimin e një paneli, sipas nenit 6 të Mirëkuptimit të OBT-së për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.

4. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas çdo marrëveshjeje tjetër të tregtisë ndërkombëtare konsiderohen se janë nisur me kërkesën e një pale për krijimin e një paneli, në përputhje me dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të asaj Marrëveshjeje.

Neni 5 Shërbime të mira dhe pajtimi

1. Shërbimet e mira dhe pajtimi janë procedura që mund të ndërmerren vullnetarisht, nëse palët në mosmarrëveshje bien dakord për këtë qëllim.

2. Me kërkesë të palëve në një mosmarrëveshje, çdo individ ose ent i zgjedhur nga palët kërkuese mund të ofrojë shërbime të mira ose të veprojë si pajtues.

3. Procedurat që përfshijnë shërbime të mira dhe pajtim, veçanërisht qëndrimet e marra aty nga palët në mosmarrëveshje, do të jenë konfidenciale dhe pa cenuar të drejtat e secilës palë në çdo procedurë të mëtejshme sipas këtij Protokolli.

4. Shërbimet e mira dhe pajtimi mund të kërkohej në çdo kohë, nga çdo palë, në një mosmarrëveshje. Ato mund të fillojnë në çdo kohë dhe të ndërpriten në çdo kohë.

5. Nëse palët në një mosmarrëveshje bien dakord, procedurat për shërbime të mira ose pajtim mund të vazhdojnë ndërsa procesi i panelit sipas seksionit IV këtij Protokoll vazhdon.

SEKSIONI II PROCEDURAT E NDËRMJETËSIMIT

Neni 6

Ndërmjetësimi

Palët mund t'i drejtohen ndërmjetësimit, në lidhje me çdo çështje të përmendur në nenin 3 të këtij Protokolli, me përjashtim të masave të propozuara. Procedurat e ndërmjetësimit nuk cenojnë të drejtat e palëve në çdo procedurë tjetër sipas Marrëveshjes CEFTA ose një marrëveshjeje tjetër tregtare ndërkombëtare në të cilën palët janë palë, duke përfshirë Marrëveshjen e OBT-së.

Neni 7

Objektivi i ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi, në përputhje me këtë seksion, synon të ndihmojë palët në mosmarrëveshje në arritjen e një zgjidhjeje të ndërsjellë të kënaqshme të çdo mosmarrëveshjeje të përmendur në nenin 3 të këtij Protokolli me ndihmën e një ndërmjetësi.

Neni 8

Fillimi i procedurës së ndërmjetësimit

1. Një palë mund të kërkojë me shkrim që çdo palë tjetër të hyjë në një procedurë ndërmjetësimi. Një kërkesë e tillë do t'i drejtohet palës tjetër dhe në të njëjtën kohë do t'i njoftohet Komitetit të Përbashkët.

2. Një kërkesë e bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni do të identifikojë masën specifike në fjalë, do të japë një përshkrim të detajuar të zbatimit të masës në fjalë dhe do të paraqesë qartë shqetësimet e palës që kërkon ndërmjetësimin me atë masë.

3. Procesi i ndërmjetësimit mund të fillohet vetëm me pëlqimin e palëve në mosmarrëveshje. Kur një palë kërkon një procedim ndërmjetësimi, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, pala tjetër do ta shqyrtojë kërkesën me mirëbesim dhe do t'i përgjigjet me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 9

Përzgjedhja e ndërmjetësit

1. Me fillimin e procedurës së ndërmjetësimit sipas nenit 8(3) të këtij Protokolli, palët në mosmarrëveshje do të bien dakord për ndërmjetësin nga lista e ndërmjetësve të rënë dakord bashkërisht sipas nenit 41, paragrafi 6 të CEFTA 2006, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes për kërkesën për ndërmjetësim. Nëse palët në mosmarrëveshje nuk mund të bien dakord për ndërmjetësin brenda afatit kohor sipas fjalisë së parë, secila palë në mosmarrëveshje mund t'i kërkojë kryetarit të Komitetit të Përbashkët që të tërheqë me short ndërmjetësin nga lista e ndërmjetësve për të cilën është rënë dakord përgjithësisht sipas nenit 41, paragrafi 6 të CEFTA 2006, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Ndërmjetësi nuk duhet të jetë nga asnjëra palë në mosmarrëveshje, përveç kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe.

3. Ndërmjetësi duhet të shmangë çdo konflikt të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të interesit dhe mund t'i kërkohej nga palët në mosmarrëveshje që të nënshkruajë një deklaratë për këtë qëllim.

4. Ndërmjetësi do të ndihmojë në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe transparente palët në mosmarrëveshje për të sjellë qartësi në mosmarrëveshje dhe për të arritur një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme të mosmarrëveshjes.

5. Kodi i Sjelljes sipas shtojcës II të këtij Protokolli do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për ndërmjetësin.

Neni 10

Rregullat e procedurës së ndërmjetësimit

1. Procedura e ndërmjetësimit do të mbahet me çdo mjet të rënë dakord nga palët në mosmarrëveshje. Kur mbahet fizikisht, ajo do të zhvillohet në një vend të rënë dakord nga palët në mosmarrëveshje. Në pjesën përkatëse, nenet 1 dhe 14 të Rregullave të Procedurës, sipas shtojcës I të këtij Protokolli, do të zbatohen, *mutatis mutandis*, në procedurën e ndërmjetësimit, përveç rasteve kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe.

2. Brenda 10 ditëve nga përzgjedhja e ndërmjetësit, sipas nenit 9(1) të këtij Protokolli, pala përgjegjëse do t'i japë, me shkrim, komentet e saj ndërmjetësit dhe palës kërkuese.

3. Ndërmjetësi mund të vendosë për mënyrën më të përshtatshme për të qartësuar mosmarrëveshjen. Në veçanti, ndërmjetësi, me çdo mjet të rënë dakord nga palët në mosmarrëveshje, mund të organizojë takime ndërmjet palëve në mosmarrëveshje, të konsultohet me palët në mosmarrëveshje bashkërisht ose individualisht, të kërkojë ndihmën ose të konsultohet me ekspertët dhe palët e interesuara përkatëse dhe të sigurojë çdo mbështetje shtesë të kërkuar nga palët në mosmarrëveshje. Përpara se të angazhohet në aktivitete të tilla, ndërmjetësi duhet të kërkojë pëlqimin e palëve në mosmarrëveshje, duke përfshirë çdo kosto të mundshme.

4. Jo më vonë se 15 ditë pas datës së marrjes së komenteve me shkrim, sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe në vijim të angazhimit me palët në mosmarrëveshje, sipas paragrafit 3 të këtij neni, ndërmjetësi do të nxjerrë një drafraport me shkrim, duke ofruar një përmbledhje të shkurtër të masës në fjalë në këto procedura, procedurat e ndjekura, pikëpamjet e shprehura nga palët në mosmarrëveshje, ekspertët dhe palët e interesuara, sipas rastit, dhe çdo zgjidhje të pranuar reciprokisht si rezultati përfundimtar i këtyre procedurave, përfshirë zgjidhjet e mundshme të përkohshme. Ndërmjetësi u lejon palëve në mosmarrëveshje 10 ditë për të komentuar drafraportin. Pas shqyrtimit të komenteve të palëve në mosmarrëveshje të paraqitura brenda kësaj periudhe, ndërmjetësi do t'u dorëzojë palëve në mosmarrëveshje një raport përfundimtar me shkrim brenda 10 ditëve.

5. Brenda 5 ditëve nga data e marrjes së raportit përfundimtar, palët në mosmarrëveshje do të informojnë me shkrim ndërmjetësin nëse e pranojnë ose e refuzojnë zgjidhjen e propozuar në raport si zgjidhje të kënaqshme të ndërsjellë të mosmarrëveshjes. Palët në mosmarrëveshje i paraqesin raportin përfundimtar Komitetit të Përbashkët.

6. Procedimi i ndërmjetësimit do të përfundojë:

a) në çdo fazë të procedurës, me kërkesë me shkrim, të cilësdo prej palëve në mosmarrëveshje;

b) deri në datën e pranimit të ndërsjellë me shkrim nga palët në mosmarrëveshje, të një zgjidhjeje të propozuar në raportin e ndërmjetësit si zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e mosmarrëveshjes;

c) deri në datën e refuzimit me shkrim drejtuar ndërmjetësit dhe palës tjetër nga pala në mosmarrëveshje të zgjidhjes së propozuar në raportin e ndërmjetësit si zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e mosmarrëveshjes; ose

d) me një deklaratë me shkrim të ndërmjetësit, pas konsultimit me palët në mosmarrëveshje, se përpjekjet e mëtejshme për ndërmjetësim nuk janë të favorshme për një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme të mosmarrëveshjes.

Neni 11

Zbatimi i një zgjidhjeje të dakordësuar reciprokisht

1. Kur palët në mosmarrëveshje kanë pranuar, me shkrim, zgjidhjen e propozuar në raportin e ndërmjetësit si një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme të mosmarrëveshjes, secila palë në mosmarrëveshje do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e kësaj zgjidhjeje brenda afatit të rënë dakord.

2. Pala zbatuese do të informojë me shkrim palën tjetër dhe Komitetin e Përbashkët për çdo masë të marrë për zbatimin e zgjidhjes.

Neni 12

Konfidencialiteti i ndërmjetësit dhe marrëdhëniet me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

1. Përveç kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe, procedura e ndërmjetësit, përfshirë raportin e ndërmjetësit, është konfidencial. Detyrimi i konfidencialitetit nuk shtrihet në informacionin faktik që ekziston tashmë në *domenin* publik.

2. Pala në mosmarrëveshje nuk do të mbështetet ose nuk do të prezantojë si provë në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas këtij Protokolli ose ndonjë marrëveshje tjetër tregtare ndërkombëtare në të cilën palët në mosmarrëveshje janë palë, dhe as paneli nuk do të marrë parasysht:

a) qëndrimet e marra nga pala tjetër në mosmarrëveshje në procedurën e ndërmjetësit ose informacioni i mbledhur nga ndërmjetësi, sipas nenit 10(3) të këtij Protokolli; ose

b) një raport i lëshuar ose një zgjidhje e propozuar nga ndërmjetësi sipas nenit 10(4) të këtij Protokolli.

3. Një ndërmjetës nuk mund të veprojë si anëtar i panelit në një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij Protokolli ose Marrëveshjes së OBT-së, që përfshin të njëjtën mosmarrëveshje për të cilën ai person ka vepruar si ndërmjetës.

Neni 13

Periudhat kohore

Çdo afat i përmendur në nenet 8, 9 dhe 10 të këtij Protokolli mund të ndryshohet me marrëveshje ndërmjet palëve të mosmarrëveshjes.

Neni 14

Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësit

1. Secila palë për mosmarrëveshjen do të mbulojë shpenzimet e veta që rrjedhin nga pjesëmarrja në procedurën e ndërmjetësit.

2. Shpërblimi i ndërmjetësit do të korrespondojë me atë të një anëtari të panelit, në përputhje me nenin 15(6), të shtojcës I.

3. Palët në mosmarrëveshje do të ndajnë bashkërisht dhe në mënyrë të barabartë shpenzimet që rrjedhin nga çështjet organizative, duke përfshirë shpërblimin dhe shpenzimet e ndërmjetësit dhe çdo shpenzim tjetër, në kuadër të procedurës së ndërmjetësit.

SEKSIONI III KONSULTIMET

Neni 15

Konsultimet

1. Një palë mund të kërkojë me shkrim konsultime me çdo palë tjetër, në lidhje me çdo çështje të përmendur në nenin 3 të këtij Protokolli.

2. Pala kërkuuese ia transmeton kërkesën palës përgjegjëse. Në të njëjtën kohë, pala kërkuuese do t'ia njoftojë kërkesën Komitetit të Përbashkët. Në kërkesën e saj, pala kërkuuese duhet të parashtrojë arsyet e kërkesës, duke përfshirë identifikimin e masës specifike në fjalë dhe bazën ligjore për ankesën.

3. Palët kërkuuese dhe përgjegjëse do të hyjnë në konsultime sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga pala përgjegjëse, me përjashtim të rasteve urgjente. Në rastet urgjente, duke përfshirë ato që përfshijnë mallra ose shërbime që prishen ose sezonale që humbin me shpejtësi vlerën e tyre tregtare, konsultimet do të fillojnë brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga pala përgjegjëse.

4. Çdo palë, përveç palëve kërkuuese dhe përgjegjëse, që çmon se ka interes në këtë çështje, mund të paraqesë një kërkesë me shkrim për të marrë pjesë në konsultime, duke shpjeguar interesin e saj në këtë çështje palëve të mosmarrëveshjes dhe Komitetit të Përbashkët, brenda pesë ditëve nga data e qarkullimit të kërkesës për konsultime. Kjo palë do t'i bashkohet konsultimeve, me kusht që pala së cilës i është drejtuar kërkesa për konsultime, të pranojë, brenda 5 ditëve nga marrja e kësaj kërkesë, që pretendimi i interesit është i bazuar. Në këtë rast, pala së cilës i është drejtuar kërkesa për konsultime, do të informojë në këtë mënyrë palën që kërkon t'i bashkohet konsultimeve dhe Komitetit të Përbashkët.

5. Palët konsultuese do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur në një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme të çështjes nëpërmjet konsultimeve. Për këtë qëllim, secila palë konsultuese do të japë informacion të mjaftueshëm për të mundësuar një shqyrtim të plotë të çështjes në fjalë dhe do të mbrojë çdo informacion konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar të shkëmbyer gjatë konsultimeve, siç kërkohet nga pala që jep informacionin. Çdo palë konsultuese do të vërë në dispozicion personelin e autoriteteve të saj ose organeve të tjera rregullatore që kanë ekspertizë në çështjen në fjalë.

6. Konsultimet do të mbahen me çdo mjet të rënë dakord ndërmjet palëve konsultuese. Kur mbahen fizikisht, ato do të zhvillohen në një vend të rënë dakord nga palët konsultuese.

7. Konsultimet janë konfidenciale dhe pa cenuar të drejtat e ndonjë pale në çdo procedurë të mëtejshme sipas Marrëveshjes CEFTA.

SEKSIONI IV PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

Neni 16 Krijimi i një paneli

1. Një palë mund të kërkojë, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës përgjegjëse, krijimin e një paneli nëse konsultimet sipas seksionit III të këtij Protokolli nuk kanë arritur të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për konsultime ose, në raste urgjente, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për konsultime. Në të njëjtën kohë, pala kërkuuese do t'ia njoftojë kërkesën e saj Komitetit të Përbashkët.

2. Në kërkesën e saj, pala kërkuuese do të identifikojë masën specifike në fjalë dhe bazën ligjore për ankesën, duke përfshirë një shpjegim sesi masa në fjalë përbën shkelje të Marrëveshjes CEFTA dhe një tregues nëse janë mbajtur konsultime. Në rast se pala kërkuuese kërkon krijimin e një paneli me kushte të ndryshme nga standardet e referencës, sipas nenit 17

të këtij Protokolli, kërkesa me shkrim do të përfshijë tekstin e propozuar të termave të posaçme të referencës.

3. Data e krijimit të një paneli do të jetë data në të cilën anëtari i fundit i panelit zgjidhet sipas nenit 18 të këtij Protokolli.

4. Një panel nuk mund të krijohet për të shqyrtuar një masë të propozuar.

5. Kur më shumë se një palë kërkon krijimin e një paneli për të njëjtën çështje, duhet të krijohet një panel i vetëm për të shqyrtuar ankesat kurdoherë që është e mundur.

6. Nëse krijohet më shumë se një panel për të shqyrtuar ankesat në lidhje me të njëjtën çështje, në masën më të gjerë të mundshme të njëjtët persona do të veprojnë si anëtarë në secilin prej paneleve të posaçme dhe orari për procedurat e panelit në këto mosmarrëveshje do të harmonizohet.

Neni 17

Termet e referencës

1. Përveç kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe, brenda 5 ditësh pune nga data e krijimit të panelit, sipas nenit 16 të këtij Protokolli, termat standarde të referencës së panelit do të jenë:

“Për të shqyrtuar, duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes CEFTA, mosmarrëveshjen e përmendur në kërkesën për krijimin e panelit, dhe për të nxjerrë rezultate, përcaktime dhe vendime në përputhje me Protokollin Shtesë 7.”

2. Nëse palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe nga termat standarde të referencës, termat e tillë të referencës do t’i njoftohen panelit, brenda 3 ditëve pune pas marrëveshjes së tyre.

3. Paneli mund të vendosë mbi juridiksionin e vet në bazë të termave të referencës.

Neni 18

Përbërja e panelit

1. Paneli do të përbëhet nga tre anëtarë të përzgjedhur ose të tërhequr, me qëllim që të sigurohet ekspertizë specifike, në lidhje me mosmarrëveshjen specifike në fjalë.

2. Palët në mosmarrëveshje do të konsultohen me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje për përbërjen e panelit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për krijimin e panelit, sipas nenit 16 të këtij Protokolli.

3. Nëse paneli nuk formohet brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 2, çdo palë në mosmarrëveshje mund t’i kërkojë kryetarit të Komitetit të Përbashkët që të nxjerrë me short anëtarët e panelit nga listat e përcaktuara sipas neneve 20 dhe 21 të këtij Protokolli. Kryetari i Komitetit të Përbashkët do të tërheqë anëtarët e panelit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Nëse paneli nuk formohet brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, Sekretariati i CEFTA-s do të nxjerrë me short anëtarët e panelit nga listat e përcaktuara sipas neneve 20 dhe 21 të këtij Protokolli, pa vonesa të panevojshme. Kryetari i Komitetit të Përbashkët ose Sekretariati i CEFTA-s do të ftojë dhe do t’u japë një mundësi të arsyeshme përfaqësuesve të secilës palë në mosmarrëveshje që të jenë të pranishëm, me çdo mjet, kur të hidhet shorti. Një anëtar i panelit do të tërhiqet nga lista e palës kërkuese, një anëtar i panelit do të tërhiqet nga lista e palës përgjegjëse dhe një anëtar i panelit do të tërhiqet nga lista e kryetarëve.

4. Nëse ka dy ose më shumë palë kërkuese, listat e secilës prej palëve kërkuese do të kombinohen për të nxjerrë një anëtar të panelit nga lista e kombinuar.

5. Kur një palë në mosmarrëveshje nuk ka njoftuar listën e saj, sipas nenit 20 të këtij Protokolli, anëtari i panelit do të tërhiqet nga lista e krijuar sipas nenit 21 të këtij Protokolli,

duke përfshirë rastin kur një palë në mosmarrëveshje nuk ka emëruar ndonjë individ për listën, sipas nenit 21 të këtij Protokolli. Në rast se nuk është krijuar asnjë listë sipas nenit 21, anëtari i panelit do të tërhiqet nga listat e anëtarëve të panelit të njoftuara nga palët jo në mosmarrëveshje.

6. Në rast se kryetari hidhet me short, Sekretariati i CEFTA-s do të përgatisë listat përkatësisht përpara shortit dhe do të zbatohen si më poshtë:

a) Në rastin e një ankuesi, kryetari do të nxirret me short nga një listë që përfshin vetëm kryetarët e mundshëm nga brenda CEFTA-s dhe vetëm nga listat e palëve jokontestuese. Në rast se ndonjëra nga palët në mosmarrëveshje nuk pajtohet për kryetarin e zgjedhur, kryetari do të tërhiqet sërish me short nga një listë që përfshin vetëm kryesuesit e mundshëm që vijnë nga jashtë CEFTA-s dhe nuk do të tërhiqet nga lista e asnjërës prej palëve kontestuese të CEFTA-s.

b) Në rastin e ankuesve të shumtë, kryetari do të nxirret me short nga një listë që përfshin vetëm kryetarët e mundshëm që vijnë nga jashtë CEFTA-s dhe shorti nuk do të përmbajë asnjë kryetar të mundshëm nga lista e palëve kontestuese të CEFTA-s. Në rast se të gjitha palët e CEFTA-s janë palë në mosmarrëveshje, shorti do të përfshijë kryetarët e mundshëm që vijnë nga jashtë CEFTA-s nga listat e të gjitha palëve të CEFTA-s.

7. Një individ nuk mund të veprojë si anëtar i panelit në një mosmarrëveshje në të cilën ai ose ajo ka qenë i përfshirë më parë në çfarëdo cilësie.

8. Një anëtar i panelit mund të zëvendësohet vetëm për arsyet dhe në përputhje me nenin 12 të shtojcës I të këtij Protokolli.

Neni 19

Kualifikimi i anëtarëve të panelit

1. Të gjithë anëtarët e panelit do të kenë ekspertizë në të drejtën tregtare ndërkombëtare, duke përfshirë çështjet e mbuluara nga Marrëveshja e CEFTA-s, dhe në çështjet në fjalë në mosmarrëveshjen specifike. Kryetari i panelit, gjithashtu, do të ketë ekspertizë ose përvojë në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas të drejtës tregtare ndërkombëtare.

2. Të gjithë anëtarët e panelit duhet të jenë të pavarur, të paanshëm, të veprojnë në cilësitë e tyre individuale, të mos marrin udhëzime nga asnjë organizatë apo autoritet dhe të mos jenë të punësuar nga administrata e asnjërës prej palëve në mosmarrëveshje.

3. Të gjithë anëtarët e panelit do të zgjidhen rreptësisht në bazë të objektivitetit, besueshmërisë dhe gjykimit të shëndoshë, duke marrë parasysh ekspertizën e tyre specifike në çështjet e rëndësishme për mosmarrëveshjen specifike.

4. Të gjithë anëtarët e panelit duhet të respektojnë Kodin e Sjelljes në shtojcën II të këtij Protokolli.

Neni 20

Listat e anëtarëve të panelit

1. Çdo palë, brenda 30 ditëve nga ratifikimi, pranimi ose miratimi i këtij Protokolli, do t'i njoftojë Komitetit të Përbashkët një listë të individëve, të cilët janë të gatshëm dhe të aftë të veprojnë si anëtarë të panelit sipas këtij Protokolli.

2. Çdo listë do të përfshijë të paktën tetë individë me lloje të ndryshme të ekspertizës specifike, të cilët mund të jenë nga pala propozuese e CEFTA-s, nga një palë e CEFTA-s jopropozuese ose nga jashtë CEFTA-s. Të paktën katër nga këta individë duhet të jenë nga jashtë CEFTA-s me lloje të ndryshme ekspertize specifike.

3. Secila palë, në çdo kohë, mund t'i njoftojë Komitetit të Përbashkët individë shtesë që janë të gatshëm dhe të aftë të veprojnë si anëtarë të panelit sipas këtij Protokolli.

4. Me kërkesë të një pale, Komiteti i Përbashkët mund të miratojë një vendim për të hequr një individ nga lista e asaj pale. Pas largimit të një individi, një zëvendësim i njoftohet Komitetit të Përbashkët në bazë të paragrafit 3 të këtij neni.

5. Sekretariati i CEFTA-s do të mbajë listat e palëve të anëtarëve të panelit dhe do t'i mbajë të përditësuara.

Neni 21

Lista e kryetarëve

1. Çdo palë, brenda 30 ditëve nga ratifikimi, pranimi ose miratimi i këtij Protokolli, do t'i paraqesë Komitetit të Përbashkët një listë të individëve, të cilët janë të gatshëm dhe të aftë që të veprojnë si kryetar.

2. Çdo listë do të përfshijë një minimum prej tre dhe maksimum prej pesë individësh nga pala e propozuar e CEFTA-s dhe një minimum prej tre dhe maksimum prej pesë individësh nga jashtë CEFTA-s. Profilet e dorëzuara duhet të pasqyrojnë lloje të ndryshme të ekspertizës të së drejtës tregtare ndërkombëtare.

3. Brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli, Komiteti i Përbashkët do të miratojë listën e kryetarëve.

4. Në rast se lista e kryetarëve nuk miratohet, kryetarët për procedurat e veçanta të panelit do të nxirren nga listat e anëtarëve të panelit të njoftuara nga palët jokontestuese, në përputhje me nenin 18(6) të këtij Protokolli.

5. Me kërkesë të një pale, Komiteti i Përbashkët mund të miratojë një vendim për të hequr një individ nga lista e kryetarëve. Pas shkarkimit të një individi, një zëvendësues do t'i propozohet Komitetit të Përbashkët për miratim dhe përfshirje në listën e kryetarëve.

6. Sekretariati i CEFTA-s mban listën e kryetarëve dhe e mban të përditësuar.

Neni 22

Funksioni i një paneli

1. Funksioni i një paneli është të bëjë një vlerësim objektiv të mosmarrëveshjes përpara tij, duke përfshirë një vlerësim objektiv të fakteve të rastit dhe zbatueshmërinë, dhe përputhshmërinë me Marrëveshjen e CEFTA-s dhe të arrijë rezultate, përcaktime dhe vendime të tilla siç kërkohen në termat e tij të referencës.

2. Paneli do të kryejë funksionet e tij dhe do t'i zhvillojë procedurat e tij, në përputhje me dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të këtij Protokolli, duke përfshirë Rregullat e Procedurës në shtojcën I të këtij Protokolli.

3. Një panel do të interpretojë Marrëveshjen e CEFTA-s, në përputhje me rregullat zakonore të interpretimit të së drejtës ndërkombëtare publike. Paneli do të marrë parasysh interpretimet përkatëse në raportet e paneleve dhe Organit të Apelimit, të miratuara nga Organi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të OBT-së, në lidhje me rregullat e Marrëveshjes së OBT-së që janë ekuivalente kryesisht me rregullat e Marrëveshjes CEFTA.

4. Rezultatet, përcaktimet dhe vendimet e një paneli nuk mund të shtojnë apo pakësojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas Marrëveshjes CEFTA.

Neni 23

Rregullat e procedurës

Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para një paneli do të udhëhiqen nga rregullat e procedurës në shtojcën I të këtij Protokolli.

Neni 24

Pjesëmarrja e palës së tretë

1. Çdo palë, përveç palëve kontestuese, që çmon se ka një interes thelbësor në mosmarrëveshjen para panelit, do të ketë të drejtë të marrë pjesë në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve si palë e tretë. Kjo palë do t'u transmetojë një njoftim me shkrim palëve në mosmarrëveshje brenda 5 ditëve nga data e qarkullimit të kërkesës për krijimin e panelit, sipas nenit 16 të këtij Protokolli. Një palë e tretë duhet t'ia paraqesë njoftimin e saj Komitetit të Përbashkët.

2. Palët e treta kanë të drejtë të bëjnë parashtrime me shkrim, të marrin parashtrimet me shkrim të palëve kontestuese, të marrin pjesë në të gjitha seancat dhe t'i paraqesin mendimet e tyre gojarisht panelit. Parashtrimet nga palët e treta do t'u dorëzohen palëve kontestuese dhe do të pasqyrohen në raportin e panelit.

Neni 25

Pezullimi dhe përfundimi i procedurave

1. Paneli mund të pezullojë punën e tij në çdo kohë me kërkesë të palës kërkuese ose, nëse ka më shumë se një palë kërkuese, me kërkesë të përbashkët të palëve kërkuese. Në kërkesën për pezullim duhet të përcaktohet periudha e pezullimit, e cila nuk duhet të kalojë 12 muaj të njëpasnjëshëm. Në rast të një pezullimi të tillë, të gjitha afatet kohore përkatëse të përcaktuara në seksionet IV dhe V, të këtij Protokolli dhe në Rregullat e Procedurës në shtojcën I, të këtij Protokolli, do të zgjaten me kohën për të cilën është pezulluar puna.

2. Paneli do të rifillojë punën e tij me kërkesë të palës kërkuese ose palëve kërkuese. Nëse nuk ka kërkesë për rifillimin e punës së panelit deri në fund të periudhës së specifikuar në kërkesën për pezullim, paneli do ta ndërpresë procedurën.

3. Paneli do të përfundojë procedurat e tij me kërkesë të përbashkët të palëve në mosmarrëveshje ose nëse palët në mosmarrëveshje bien dakord për një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme. Kostot dhe shpenzimet e shkaktuara deri në atë moment, do të ndahen në përputhje me nenin 15(5), të shtojcës I, të këtij Protokolli.

4. Pala kërkuese mund të tërheqë ankesën e saj në çdo kohë, veprim që sjell përfundimin e procedurave. Kostot dhe shpenzimet e shkaktuara deri në atë moment, do të ndahen në përputhje me nenin 15(5), të shtojcës I, të këtij Protokolli.

Neni 26

Raporti i ndërmjetëm

1. Paneli do t'u paraqesë palëve kontestuese një raport të ndërmjetëm brenda 140 ditëve nga data e krijimit të panelit. Në raste urgjente, paneli do të përpiqet t'u paraqesë palëve në mosmarrëveshje një raport të ndërmjetëm brenda 100 ditëve nga data e krijimit të panelit. Nëse paneli vlerëson se nuk mund të lëshojë raportin e ndërmjetëm brenda 140 ditëve, ai do t'i informojë me shkrim palët në mosmarrëveshje për arsyet e vonës së bashku me një vlerësim të periudhës brenda së cilës do të lëshojë raportin e ndërmjetëm. Çdo vonës nuk duhet të kalojë një periudhë prej 30 ditësh.

2. Raporti i ndërmjetëm duhet të përmbajë:

a) rezultatet faktike;

b) përcaktimet ligjore nëse masa në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes CEFTA;

c) arsyet për konstatimet faktike dhe përcaktimet ligjore;

d) rekomandimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; dhe

e) rekomandimi për një periudhë të arsyeshme kohore për të arritur pajtueshmërinë sipas nenit 31 të këtij Protokolli, nëse masa në fjalë rezulton të jetë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes CEFTA.

3. Secila palë kontestuese mund t'i paraqesë panelit komente me shkrim për raportin e ndërmjetëm brenda afatit kohor të caktuar nga paneli. Pas shqyrtimit të çdo komenti të tillë, paneli mund të ndryshojë raportin e ndërmjetëm ose të kryejë ndonjë shqyrtim të mëtejshëm që e vlerëson të përshtatshëm.

4. Raporti i ndërmjetëm do të jetë konfidencial për palët në mosmarrëveshje.

Neni 27

Raporti përfundimtar

1. Paneli do t'u paraqesë një raport përfundimtar palëve në mosmarrëveshje, brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të ndërmjetëm palëve në mosmarrëveshje. Në të njëjtën kohë, paneli ia transmeton raportin përfundimtar Komitetit të Përbashkët.

2. Përveç rezultateve dhe përcaktimeve të përmendura në nenin 26(2), raporti përfundimtar do të përcaktojë vendimin e panelit, i cili do të jetë i detyrueshëm për palët në mosmarrëveshje, si dhe sasinë dhe ndarjen e kostove të mosmarrëveshjes dhe nivelin e anulimit ose zhvlerësimit. Paneli do t'i ndajë këto kosto në bazë të kohës së shpenzuar për sfidat ligjore të suksesshme dhe të pasuksesshme të sjella nga pala ose palët kërkuese, në bazë të nenit 15(3), të shtojcës I të këtij Protokolli, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e palëve të treta.

3. Sekretariati i CEFTA-s do ta vendosë në dispozicion publikisht raportin përfundimtar brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij sipas paragrafit 1, duke iu nënshtruar mbrojtjes së informacionit konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar, në përputhje me nenin 8, të shtojcës I të këtij Protokolli.

Neni 28

Arbitrazhi i detyrueshëm për shqyrtimin e apelit

1. Me marrëveshje midis palëve në mosmarrëveshje, të arritur në çdo kohë përpara nxjerrjes së raportit të ndërmjetëm, raporti përfundimtar mund t'i nënshtrohet shqyrtimit të apelit me anë të arbitrazhit detyrues. Marrëveshja do t'i njoftohet Komitetit të Përbashkët.

2. Brenda 30 ditëve nga nxjerrja e raportit përfundimtar dhe me kërkesë të një ose më shumë palëve në mosmarrëveshje, raporti përfundimtar do t'i nënshtrohet shqyrtimit të apelit me anë të arbitrazhit detyrues.

3. Shqyrtimi i apelit do të kufizohet në çështjet ligjore të mbuluara në raportin përfundimtar dhe interpretimet ligjore të zhvilluara nga paneli.

4. Tre arbitra do të tërhiqen nga lista e kryetarëve të krijuar sipas nenit 21(3) të këtij Protokolli dhe do të kufizohen tek individët e emëruar nga palët jokontestuese. Nëse nuk është krijuar asnjë listë e kryetarëve sipas nenit 21(3) të këtij Protokolli, tre arbitrat do të tërhiqen nga listat e anëtarëve të panelit të njoftuara nga palët që nuk janë në mosmarrëveshje dhe do të jenë nga jashtë CEFTA-s. Arbitrat do të bien dakord për kryetarin për shqyrtimin e apelit. Për tërheqjen e arbitrave, do të zbatohet neni 18(3), *mutatis mutandis*.

5. Për shqyrtimin e apelit, do të zbatohen procedurat e parashikuara në seksionin IV dhe shtojcën I të këtij Protokolli, *mutatis mutandis*.

6. Raporti i shqyrtimit të apelit do të lëshohet brenda 90 ditëve nga data e përzgjedhjes së arbitrave dhe afatet kohore procedurale përkatëse do të rregullohen në përputhje me rrethanat.

7. Raporti i shqyrtimit të apelit do të jetë përfundimtar dhe detyrues, dhe do t'i njoftohet Komitetit të Përbashkët. Sekretariati i CEFTA-s do ta bëjë publikisht të disponueshëm raportin e shqyrtimit të apelit.

SEKSIONI V PROCEDURAT E PAJTUESHMËRISË

Neni 29 **Pajtueshmëria**

1. Pala përgjegjëse do të marrë menjëherë çdo masë të nevojshme për të përmbushur vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit nëse, në atë raport, paneli ose arbitrat përcaktojnë se masa në fjalë nuk është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA.

2. Jo më vonë se 20 ditë pas datës së marrjes së raportit përfundimtar ose, nëse apelohej, njoftimit të raportit të rishikimit të apelit në Komitetin e Përbashkët, pala përgjegjëse do të informojë çdo palë tjetër kontestuese dhe Komitetin e Përbashkët mbi qëllimin e saj për të përmbushur vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit brenda periudhës së arsyeshme kohore.

3. Nëse pala përgjegjëse nuk mund të njoftojë synimin e saj për të përmbushur vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit, ose nëse pala përgjegjëse njofton synimin e saj për të mos përmbushur vendimin në raportin përfundimtar, ose në raportin e shqyrtimit të apelit, pala kërkuese, ose, nëse ka më shumë se një palë kërkuese, palët kërkuese kanë të drejtë të pezullojnë menjëherë detyrimet ndaj palës përgjegjëse, në përputhje me nenin 33, pikat 2 deri në 6, të këtij Protokolli.

Neni 30 **Periudha e arsyeshme kohore për pajtueshmëri**

1. Nëse është e pamundur të zbatohen menjëherë rekomandimet dhe vendimet, pala përgjegjëse duhet t'i përmbahet periudhës së arsyeshme kohore brenda së cilës të arrihet pajtueshmëria, siç përcaktohet në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit.

2. Në përcaktimin e periudhës së arsyeshme kohore për pajtueshmëri, paneli ose arbitrat do të marrin parasysh se periudha e arsyeshme kohore për pajtueshmëri nuk duhet të kalojë 6 muaj nga miratimi i raportit përfundimtar ose raportit të shqyrtimit të apelit.

3. Në varësi të rrethanave të veçanta të çështjes në fjalë dhe nëse palët në mosmarrëveshje bien dakord, periudha kohore për pajtueshmëri mund të jetë më e gjatë se 6 muaj, por nuk duhet të kalojë 9 muaj.

4. Periudha e arsyeshme kohore për pajtueshmërinë e përcaktuar nga paneli ose arbitrat, mund të zgjatet me marrëveshje të ndërsjellë të palëve kontestuese.

5. Pala përgjegjëse do të njoftojë çdo palë tjetër në mosmarrëveshje dhe Komitetin e Përbashkët përpara përfundimit të periudhës së arsyeshme kohore për pajtueshmërinë e masave që ka marrë për të zbatuar vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit.

Neni 31 **Rishikimi i pajtueshmërisë**

1. Çdo mosmarrëveshje për pajtueshmërinë do t'i referohet panelit fillestar të krijuar sipas nenit 16 të këtij Protokolli.

2. Një mosmarrëveshje mbi pajtueshmërinë cilësohet se ekziston kur palët në mosmarrëveshje nuk pajtohen, nëse:

a) pala përgjegjëse ka marrë një masë për t'iu përmbajtur vendimit në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të ankesës; dhe/ose

b) një masë e marrë për t'u pajtuar me vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA; dhe/ose

c) një masë e marrë për t'u pajtuar me vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit pas pezullimit të detyrimeve, në përputhje me nenin 34 të këtij Protokolli, është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA; dhe/ose

d) niveli i pezullimit të detyrimeve në përputhje me nenin 33(3) të këtij Protokolli është i barabartë me anulimin ose dëmin e shkaktuar nga mospërputhja me Marrëveshjen CEFTA, siç përcaktohet në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit.

3. Në rast mosmarrëveshjeje për pajtueshmërinë sipas paragrafit 2 të këtij neni, pala kërkuese do të rimbledhë panelin fillestar, duke ia përcjellë një kërkesë me shkrim panelit fillestar. Nëse ka më shumë se një palë kërkuese, një kërkesë e tillë do të bëhet të paktën nga njëra prej palëve kërkuese. Një kërkesë me shkrim për rimbledhjen e panelit fillestar, do t'i njoftohet çdo pale tjetër në mosmarrëveshje dhe Komitetit të Përbashkët.

4. Paneli fillestar, i rimbledhur sipas paragrafit 3 të këtij neni, do t'ua paraqesë raportin e tij të pajtueshmërisë palëve në mosmarrëveshje, brenda 90 ditëve nga data e kërkesës së bërë në rast të mosmarrëveshjes për pajtueshmërinë. Në të njëjtën kohë, paneli do t'ia transmetojë raportin e pajtueshmërisë Komitetit të Përbashkët. Sekretariati i CEFTA-s do ta vendosë në dispozicion publikisht raportin e pajtueshmërisë, brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij palëve në mosmarrëveshje, duke iu nënshtruar mbrojtjes së informacionit konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar, në përputhje me Rregullat e Procedurës në shtojcën I të këtij Protokolli.

5. Në rast se paneli fillestar ose një, ose më shumë anëtarë të tij, nuk mund të rimblidhen për një rishikim të pajtueshmërisë, do të zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 18 të këtij Protokolli. Afati kohor për paraqitjen e një raporti pajtueshmërie të palët në mosmarrëveshje, do të zgjatet me 30 ditë.

6. Raporti i pajtueshmërisë do të jetë i detyrueshëm për palët në mosmarrëveshje.

7. Pala kërkuese nuk do të pezullojë detyrimet në përputhje me nenin 33 të këtij Protokolli derisa paneli të ketë dorëzuar raportin e tij të pajtueshmërisë.

Neni 32

Kompensimi i përkohshëm

Në mungesë të pajtueshmërisë nga pala përgjegjëse, palët në mosmarrëveshje mund të bien dakord për një kompensim reciprokisht të pranueshëm. Kompensimi është vullnetar dhe, nëse jepet, do të jetë në përputhje me Marrëveshjen CEFTA.

Neni 33

Pezullimi i detyrimeve

1. Pala kërkuese ose, nëse ka më shumë se një palë kërkuese, palët kërkuese, në mungesë të një kompensimi reciprokisht të pranueshëm të rënë dakord me palën përgjegjëse, sipas nenit

32 të këtij Protokolli, kanë të drejtë të pezullojnë menjëherë detyrimet kundrejt palës përgjegjëse, nëse:

a) Pala përgjegjëse nuk njofton një masë të marrë për të përmbushur vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit, në përputhje me nenin 30(5) të këtij Protokolli; ose

b) Paneli i rimbledhur, sipas nenit 31 të këtij Protokolli, përcakton se një masë e marrë për t'u përmbushur nuk është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA.

2. Përpara se të pezullojë detyrimet, një palë kërkuese duhet të njoftojë palën përgjegjëse dhe Komitetin e Përbashkët mbi synimin e saj për të pezulluar detyrimet, duke përfshirë nivelin e detyrimeve që synon të pezullojë.

3. Pala kërkuese mund të pezullojë çdo detyrim sipas Marrëveshjes CEFTA. Niveli i këtij pezullimi do të jetë i barabartë me anulimin ose dëmin e shkaktuar nga mospërputhja me Marrëveshjen CEFTA, siç përcaktohet në raportin përfundimtar, ose në raportin e shqyrtimit të apelit. Niveli i anulimit ose zhvlerësimit do të llogaritet në datën e paraqitjes së raportit përfundimtar, ose raportit të rishikimit të apelit tek palët në mosmarrëveshje.

4. Një palë kërkuese mund të zbatojë pezullimin e detyrimeve 15 ditë pune pas datës së njoftimit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

5. Çdo pezullim i detyrimeve do të jetë i përkohshëm dhe do të zbatohet vetëm derisa pala përgjegjëse të ketë marrë një masë për të zbatuar vendimin në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit, siç përcaktohet në nenin 34 të këtij Protokolli, ose derisa palët në mosmarrëveshje të kenë zgjidhur mosmarrëveshjen.

6. Asgjë në këtë Protokoll nuk do të përjashtojë një palë nga zbatimi i pezullimit të detyrimeve të autorizuar nga Organi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të OBT-së. Asnjë palë kontestuese nuk mund të thirret në Marrëveshjen e OBT-së për të përjashtuar ndonjë palë tjetër kontestuese nga pezullimi i detyrimeve në përputhje me këtë nen.

Neni 34

Pajtueshmëria pas pezullimit të detyrimeve

1. Kur, pas pezullimit të detyrimeve, pala përgjegjëse merr një masë për t'iu përmbajtur vendimit në raportin përfundimtar ose në raportin e shqyrtimit të apelit, pala përgjegjëse do të njoftojë çdo palë tjetër kontestuese dhe do të kërkojë përfundimin e pezullimit të detyrimeve të zbatuara nga cilado palë kërkuese. Në të njëjtën kohë, pala përgjegjëse do t'ia transmetojë njoftimin e saj Komitetit të Përbashkët.

2. Nëse pala kërkuese vlerëson se masa e marrë nga pala përgjegjëse për t'iu përmbajtur vendimit në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit nuk është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA, pala kërkuese mund të kërkojë rimbledhjen e panelit, në përputhje me nenin 31(2) (c) dhe (3) të këtij Protokolli. Në të njëjtën kohë, kjo palë kërkuese do t'ia transmetojë kërkesën e saj çdo pale tjetër kontestuese dhe Komitetit të Përbashkët.

3. Secila palë kërkuese do të përfundojë pezullimin e detyrimeve, nëse paneli konstaton se masa e marrë për të përmbushur raportin përfundimtar ose raportin e shqyrtimit të apelit nga pala përgjegjëse, është në përputhje me Marrëveshjen CEFTA.

SEKSIONI VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Ndryshimi i Protokollit

1. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë këtë Protokoll.
2. Teksti i ndryshuar do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 38 të këtij Protokolli.

Neni 36

Miratimi ose ndryshimi i shtojcave të këtij Protokolli

1. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të miratojë dhe të ndryshojë shtojcat e këtij Protokolli, të cilat janë pjesë integrale e këtij Protokolli.
2. Vendimet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 38 të këtij Protokolli.

Neni 37

Ndryshimi i CEFTA 2006

Ky Protokoll është pjesë integrale e CEFTA 2006 dhe shfuqizon, dhe zëvendëson nenet 42 dhe 43 të CEFTA 2006, dhe anekset 8 dhe 9 të CEFTA 2006 pasi Protokollin të ketë hyrë në fuqi për të gjitha palët e CEFTA-s.

Neni 38

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit në përputhje me kërkesat e parashikuara nga rregulloret përkatëse të palëve. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen tek Depozitari.
2. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi pasi të gjitha palët të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi ose miratimit.
3. Nëse Protokollin nuk ka hyrë në fuqi për të gjitha palët, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, brenda tre viteve nga miratimi, ai do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimi ose miratimit dhe do të zbatohet për ato palë që kanë depozituar instrumentin e tyre përkatës të ratifikimit, pranimi ose miratimit, në lidhje me çdo mosmarrëveshje me një palë tjetër që tashmë zbaton këtë Protokoll.
4. Për çdo palë që depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimi ose miratimit, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij dhe Protokollin do të zbatohet, në lidhje me çdo mosmarrëveshje me një palë tjetër për të cilën tashmë zbatohet ky Protokoll.
5. Për mosmarrëveshjet ndërmjet palëve që nuk e kanë depozituar ende instrumentin e tyre përkatës të ratifikimit, pranimi ose miratimit dhe për mosmarrëveshjet midis këtyre palëve, dhe palëve që kanë depozituar tashmë instrumentin e tyre përkatës të ratifikimit, pranimi ose miratimit, do të vazhdojnë të zbatohen nenet 42 dhe 43 të dhe anekset 8 dhe 9 të CEFTA 2006.

Miratuar në praninë e përfaqësuesve të të gjitha palëve të CEFTA-s.

Bërë në Beograd, më 9 tetor 2024, në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze dhe depozituar te Depozitari i Marrëveshjes CEFTA, i cili do t'u transmetojë kopje të certifikuara të gjitha palëve të Marrëveshjes CEFTA.

SHTOJCA I RREGULLAT E PROCEDURËS

Neni 1 **Komunikimet**

1. Përveç kur kërkohet ndryshe nga një palë e interesuar, të gjitha komunikimet e bëra nga palët e interesuara dhe nga paneli do të bëhen nëpërmjet Sekretariatit të CEFTA-s. Një palë e interesuar mund të vendosë që informacioni i përcaktuar si konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar të mos komunikohet nëpërmjet Sekretariatit të CEFTA-s, por nëpërmjet çdo mjeti tjetër të koordinuar me Sekretariatit të CEFTA-s dhe që i nënshtrohet modaliteteve të propozuara sipas rastit nga Sekretariati i CEFTA-s dhe i miratuar nga pala përkatëse e interesuar.

2. Nuk do të ketë komunikime *ex parte* ndërmjet palëve të interesuara dhe panelit, në lidhje me çështjet në shqyrtim nga paneli.

3. Çdo komunikim zyrtar verbal ose me shkrim i bërë nga palët e interesuara dhe nga paneli do të jetë në gjuhën angleze. Raporti i ndërmjetëm, raporti përfundimtar dhe raporti i shqyrtimit të apelit do të nxirren në gjuhën angleze.

4. Një sistem i dedikuar i komunikimit elektronik do të vendoset dhe mirëmbahet nga Sekretariati i CEFTA-s dhe, përveç rastit kur kërkohet ndryshe nga një palë e interesuar, çdo komunikim ose dokument me shkrim do të transmetohet nëpërmjet sistemit të komunikimit elektronik. Një palë e interesuar mund të vendosë që informacioni i përcaktuar si konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar të mos ndahet nëpërmjet sistemit të komunikimit elektronik, por me çdo mjet tjetër të koordinuar me Sekretariatit të CEFTA-s.

5. Deri në krijimin e një sistemi të komunikimit *online*, përveç kur kërkohet ndryshe nga një palë e interesuar, palët e interesuara dhe paneli do t'ia transmetojnë çdo komunikim ose dokument me shkrim Sekretariatit të CEFTA-s në mënyrë elektronike dhe duke depozituar një kopje në letër. Një palë e interesuar mund të vendosë që informacioni i përcaktuar si konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar të mos dërgohet në mënyrë elektronike dhe as duke depozituar një kopje në letër, por me çdo mjet tjetër të koordinuar me Sekretariatit të CEFTA-s.

6. Nëse nuk provohet ndryshe, data dhe ora e depozitimit të dokumentit në sistemin e komunikimit elektronik ose konfirmimi nga Sekretariati i CEFTA-s për dorëzimin e kopjes në letër, ose për dorëzimin me mjete të tjera të koordinuara me Sekretariatit, do të jetë dëshmi e transmetimit për të gjitha qëllimet procedurale.

7. Gabimet e vogla të një natyre klerikale/administrative në një dokument mund të korrigjohen me dorëzimin e një dokumenti të ri, i cili tregon qartë ndryshimet e bëra dhe zëvendëson dokumentin origjinal. Një zëvendësim i tillë nuk ndikon në dorëzimin në kohë të dokumentit origjinal.

8. Nëse dita e fundit për dorëzimin e një dokumenti është pushim zyrtar në një palë të interesuar, afati do të shtyhet deri në ditën e parë të punës në dispozicion më pas.

Neni 2 **Aksesi në informacion**

1. Modalitetet për të aksesuar informacionin e caktuar nga një palë në mosmarrëveshje ose një palë e tretë si konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar do të propozohen rast pas rasti nga Sekretariati i CEFTA-s dhe do të miratohen nga pala caktuese.

Këto modalitete do të identifikojnë listën e kufizuar të individëve të veçantë që duhet të lejohen të kenë akses në informacion.

2. Anëtarët e panelit, përfaqësuesit e palës tjetër në mosmarrëveshje ose palëve në mosmarrëveshje do të kenë akses në të gjitha informacionet, duke përfshirë informacionet e caktuara si konfidenciale, konfidenciale tregtare ose tepër konfidenciale tregtare.

Neni 3

Fillimi i procedurës

1. Përveç kur palët e interesuara bien dakord ndryshe, ato do të takohen me panelin, brenda 5 ditëve pune nga data e krijimit të tij, sipas nenit 18 të Protokollit Shtesë 7, për të përcaktuar ato çështje administrative dhe logjistike të procedurës që palët e interesuara ose paneli vlerësojnë të përshtatshme, duke përfshirë adresat elektronike ku do të dorëzohen dokumentet, numrat e telefonit dhe linqet *online* për qëllime të komunikimit ndërmjet palëve të interesuara dhe panelit.

2. Paneli do të konsultohet me palët e interesuara për kostot e pritshme të procedurës, me qëllim që të minimizohen kostot e tilla.

3. Paneli dhe përfaqësuesit e palëve do të kryejnë aktivitetet, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, nëpërmjet komunikimit elektronik.

Neni 4

Puna e panelit

1. Kryetari i panelit do të kryesojë të gjitha mbledhjet e procedurës. Kryetari i panelit ka autoritetin për të marrë vendime për çështjet administrative të procedurës. Paneli mund t'i delegojë kryetarit autoritetin për të marrë vendime për çështjet procedurale të procedurës.

2. Seancat dëgjimore para panelit do të zhvillohen personalisht, përveç rastit kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe. Për sa i përket modaliteteve për mbajtjen e seancës dëgjimore dhe para se të angazhohet në ndonjë veprim që mund të rezultojë në kosto, paneli do të konsultohet me palët kontestuese. Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë seksion, paneli do të kryejë çfarëdolloj aktiviteti tjetër me anë të komunikimit elektronik.

3. Vetëm anëtarët e panelit mund të marrin pjesë në diskutimet e panelit. Paneli mund të lejojë asistentin e tij që të jetë i pranishëm në diskutime.

4. Hartimi i çdo vendimi, raporti të ndërmjetëm, raporti përfundimtar dhe raporti të shqyrtimit të apelit do të mbeten përgjegjësi ekskluzive e panelit ose e arbitrave dhe nuk duhet t'i delegohen asnjë pale të tretë.

5. Rezultatet, arsyetimi, përcaktimet dhe vendimet e panelit duhet të bëhen me konsensus. Nëse nuk mund të arrihet konsensus, konstatimet, arsyetimet, përcaktimet dhe vendimet e panelit do të merren nga shumica e anëtarëve të tij.

6. Asnjë anëtar i panelit nuk mund të japë një opinion të veçantë përveç kur të gjithë anëtarët e panelit bien dakord ndryshe, e në këtë rast opinionin e shprehur në raportin e panelit ose në raportin e shqyrtimit të apelit nga anëtari, ose arbitri i panelit kundërshtues do të jetë anonim.

7. Kur në procedurë lind një çështje procedurale që nuk mbulohet nga dispozitat e seksioneve IV dhe V, të Protokollit Shtesë 7, paneli, pas konsultimit me palët e interesuara, mund të miratojë një procedurë të përshtatshme që është në përputhje me ato dispozita dhe që garanton trajtim të barabartë të të gjitha palëve të interesuara.

8. Me kërkesë të një pale të interesuar ose nëse paneli vlerëson se ka nevojë për të modifikuar ndonjë afat kohor të zbatueshëm në procedurë, ose për të kryer ndonjë rregullim tjetër administrativ ose procedural, siç mund të kërkohej për drejtësinë, ose efikasitetin e procedurës,

paneli do të propozojë një ndryshim ose rregullim të arsyeshëm dhe do të konsultohet me palët në mosmarrëveshje. paneli do të informojë menjëherë palët për vendimin e tij dhe për arsyet e vendimit të tij. Përveç kur parashikohet ndryshe në Protokollin Shtesë 7, në asnjë rast ndryshimi i një afati kohor nuk duhet të kalojë 10 ditë ose një të tretën e kohëzgjatjes së afatit që zgjatet.

9. Paneli nuk do të takohet apo kontaktojë një palë të interesuar në mungesë të ndonjë pale tjetër të interesuar. Asnjë anëtar i panelit nuk do të diskutojë ndonjë aspekt të procedurës me palën e interesuar ose palët e interesuara, në mungesë të anëtarëve të tjerë të panelit.

Neni 5

Parashtrimet me shkrim

1. Pala kërkuuese do t'ia dorëzojë panelit parashtrimin e saj fillestar me shkrim, jo më vonë se 20 ditë pas datës së krijimit të panelit, sipas nenit 18 të Protokollit Shtesë 7. I njëjti afat zbatohet, nëse ka më shumë se një palë kërkuuese.

2. Pala përgjegjëse do t'ia dorëzojë panelit kundërparashtrimin e saj me shkrim jo më vonë se 25 ditë pas datës së dorëzimit të parashtrimit fillestar me shkrim nga pala kërkuuese.

3. Çdo palë e tretë do t'ia dorëzojë panelit parashtrimin e saj me shkrim, jo më vonë se 15 ditë pas datës së dorëzimit të kundërparashtrimit me shkrim nga pala përgjegjëse.

4. Pas seancës dëgjimore para panelit, palët e interesuara mund t'i paraqesin panelit një parashtrim plotësues me shkrim, në lidhje me ndonjë çështje që ka lindur gjatë seancës dëgjimore, brenda 10 ditëve nga data e seancës. Kjo zbatohet nëse ka një seancë dëgjimore shtesë, në përputhje me nenin 6(2) të kësaj shtojce.

Neni 6

Seancat dëgjimore

1. Brenda 5 ditëve nga dorëzimi i parashtrimeve të palës së tretë ose brenda 5 ditëve nga dorëzimi i kundërparashtrimeve nga pala përgjegjëse kur nuk ka palë të tretë, kryetari i panelit do të caktojë datën, orën dhe, nëse mbahet fizikisht, vendndodhjen e seancës në konsultim me palët kontestuese dhe anëtarët e tjerë të panelit. Seanca mbahet jo më vonë se 10 ditë pas dorëzimit të parashtrimeve të palës së tretë ose, kur nuk ka të tretë, jo më vonë se 25 ditë pas dorëzimit të kundërparashtrimit nga pala përgjegjëse.

2. Si rregull i përgjithshëm, duhet të ketë vetëm një seancë. Nëse mosmarrëveshja përfshin çështje me kompleksitet të jashtëzakonshëm, paneli, me nismën e tij ose me kërkesë të palës në mosmarrëveshje, mund të thërrasë një seancë shtesë.

3. Të gjithë anëtarët e panelit do të jenë të pranishëm gjatë të gjithë kohëzgjatjes së seancës.

4. Përveç kur palët kontestuese vendosin ndryshe, seancat dëgjimore të panelit do të jenë të mbyllura për publikun.

5. Personat e mëposhtëm mund të marrin pjesë në seancë, pavarësisht nëse seanca është e hapur apo e mbyllur për publikun:

- a) përfaqësuesit e palëve të interesuara;
- b) këshilltarët e palëve të interesuara;
- c) asistenti i panelit;
- d) përkthyesit, nëse ftohen nga paneli, siç është rënë dakord ndërmjet panelit dhe palëve kontestuese; dhe
- e) ekspertët, nëse ftohen nga paneli, siç është rënë dakord ndërmjet panelit dhe palëve kontestuese.

6. Jo më vonë se 5 ditë para datës së seancës dëgjimore, secila palë e interesuar do t'ia dorëzojë panelit dhe palëve të tjera të interesuara një listë me emrat e personave, të cilët do të

japin argumente ose prezantime verbale në seancë dëgjimore në emër të asaj pale të interesuar, dhe të përfaqësuesve apo këshilltarëve të tjerë, të cilët do të marrin pjesë në seancë.

7. Paneli do ta zhvillojë seancën dëgjimore në mënyrën e mëposhtme, duke garantuar që secilës palë në fjalë t'i jepet kohë e barabartë:

Argumenti:

- a) argumenti i palës ose palëve kërkuese;
- b) Argumenti i palës përgjegjëse;
- c) Argumenti i palës ose palëve të treta;

Argumenti kundërshtues:

- d) Përgjigja e palës ose palëve kërkuese;
- e) Kundërpërgjigje e palës përgjegjëse.

8. Paneli mund t'i drejtojë pyetje secilës palë të interesuar në çdo kohë gjatë seancës.

9. Paneli, pasi të ketë marrë nga palët e interesuara versionin me shkrim të argumenteve, argumentet kundërshtuese dhe përgjigjet në pyetjet e panelit, do t'i qarkullojë menjëherë të gjitha dokumentet e pranuar ndërmjet palëve të interesuara.

Neni 7

Pyetje me shkrim

1. Paneli në çdo kohë gjatë procedurës mund t'i drejtojë pyetje me shkrim cilësdo palë të interesuar. Secila palë e interesuar do të marrë një kopje të ndonjë pyetjeje me shkrim nga paneli.

2. Pala e interesuar të cilës i drejtohen pyetjet me shkrim, do të japë përgjigje me shkrim brenda afatit të caktuar nga paneli. Kjo palë e interesuar, gjithashtu, do t'i sigurojë çdo pale tjetër të interesuar një kopje të përgjigjes së saj me shkrim ndaj pyetjeve me shkrim. Çdo pale tjetër të interesuar do t'i jepet mundësia të japë komente me shkrim mbi përgjigjen me shkrim brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes.

Neni 8

Transparenca dhe konfidencialiteti

1. Seancat dëgjimore të panelit do të mbahen në seancë të mbyllur kur parashtrimet dhe argumentet e palës së interesuar përmbajnë informacione konfidenciale, konfidenciale tregtare ose tepër konfidenciale tregtare. Palët e interesuara ruajnë konfidencialitetin e seancave dëgjimore të mbajtura në seancë të mbyllur.

2. Secila palë e interesuar mund t'i bëjë të disponueshme publikisht parashtrimet e saj me shkrim, duke iu nënshtruar mbrojtjes së çdo informacioni konfidencial, konfidencial tregtar ose tepër konfidencial tregtar. Kur parashtrimi i një pale në panel përmban një informacion të tillë, ajo palë duhet të sigurojë, brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit të parashtrimit, një version jokonfidencial ose të redaktuar të parashtrimit që mund t'i zbulohet publikut.

3. Secila palë e interesuar dhe këshilltarët e saj do të trajtojnë si konfidencial, konfidencial tregtar, ose tepër konfidencial tregtar çdo informacion të dorëzuar nga ndonjë palë tjetër në panel që ajo palë e ka caktuar si konfidencial.

Neni 9

Informacioni dhe konsulenca teknike

1. Me kërkesë të palës në mosmarrëveshje ose me nismën e vet, paneli mund të kërkojë informacione dhe këshilla teknike nga çdo person ose organ që e çmon të përshtatshëm. Paneli do të informojë palët në mosmarrëveshje, në përputhje me rrethanat.

2. Kur personi ose organi në fjalë është nga cilado palë në mosmarrëveshje, paneli do ta informojë atë palë përpara se të kërkojë informacion ose këshillë të tillë. Çdo informacion i marrë nga paneli duhet t'u zbulohet palëve në mosmarrëveshje dhe të dorëzohet për komentet e tyre. Informacioni konfidencial i dhënë panelit nuk duhet të zbulohet pa autorizim zyrtar nga personi ose organi që e jep atë informacion.

Neni 10

Shkresat përmbledhëse *Amicus Curiae*

1. Përveç kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe, brenda 5 ditëve nga data e krijimit të panelit, paneli mund të marrë shkresa të pakërkuara përmbledhëse *amicus curiae* nga çdo person fizik ose juridik i vendosur në palën kontestuese dhe që nuk i përket një administrate të saj. Në raportin e tij të ndërmjetëm, raportin përfundimtar ose raportin e rishikimit të apelit, paneli do të listojë të gjitha informacionet e tilla që ka marrë, me kusht që të jenë në përputhje me rregullat sipas paragrafit 2. Paneli nuk është i detyruar të adresojë në raportin e tij të ndërmjetëm, raportin përfundimtar ose raportin e shqyrtimit të apelit, argumentet e bëra në këto shkresa përmbledhëse.

2. Çdo shkresë *amicus curiae* e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të dorëzohet në panel, brenda 15 ditëve nga data e formimit të panelit, sipas nenit 18 të Protokollit Shtesë 7. Çdo shkresë e tillë duhet të jetë e shkruar në gjuhën angleze, të mos kalojë 15 faqe të shtypura, përjashtuar çdo aneks, dhe duhet të jetë drejtpërdrejt e lidhur me mosmarrëveshjen që po shqyrtohet nga paneli. Çdo shkresë e tillë duhet të përmbajë një përshtypje të personit që e dorëzon shkresën, duke përfshirë aktivitetet dhe burimin e financimit të atij personi dhe të specifikojë natyrën e interesit që ai person ka në procedurë. Paneli do të dorëzojë për komentet e palëve në mosmarrëveshje çdo shkresë *amicus curiae* që ka marrë. Komentet e palëve në mosmarrëveshje do të dorëzohen me shkrim në panel brenda një afati të caktuar nga paneli.

Neni 11

Rastet urgjente

Në rastet urgjente në përputhje me nenin 16(1) të Protokollit Shtesë 7, paneli, pas konsultimit me palët në mosmarrëveshje, do të rregullojë afatet kohore të përmendura në këtë paragraf sipas rastit dhe do të njoftojë palët e interesuara për këto rregullime.

Neni 12

Zëvendësimi i anëtarëve të panelit

1. Nëse ndonjë anëtar i panelit nuk mund të shërbejë në një procedurë të caktuar ose tërhiqet një zëvendësues do të zgjidhet, në përputhje me nenin 18 të Protokollit Shtesë 7.

2. Kur një palë në mosmarrëveshje vlerëson se një anëtar i panelit nuk zbaton Kodin e Sjelljes në shtojcën II të Protokollit Shtesë 7 dhe për këtë arsye duhet të zëvendësohet, ajo palë do të njoftojë të gjitha palët e tjera në mosmarrëveshje, brenda 10 ditëve nga momenti që ka marrë dijeni për rrethanat, në bazë të mospërputhjes së këtij anëtari me Kodin e Sjelljes dhe të sigurojë informacionin ose provat përkatëse në lidhje me këtë.

3. Kur njoftimi sipas paragrafit 2 lidhet me një anëtar të panelit të ndryshëm nga kryetari i tij, palët në mosmarrëveshje do të konsultohen dhe nëse bien dakord, do ta shkarkojnë atë anëtar

dhe do të zgjedhin një zëvendësues, në përputhje me nenet 18(3), (4) dhe (5) të Protokollit Shtesë 7. Nëse palët në mosmarrëveshje nuk arrijnë të bien dakord për nevojën e shkarkimit dhe zgjedhjes së një zëvendësuesi të atij anëtari, çdo palë kontestuese mund të kërkojë që çështja t'i referohet kryetarit të panelit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.

a) Nëse kryetari i panelit konstaton se anëtari në fjalë nuk është në përputhje me Kodin e Sjelljes, kryetari i panelit do të nxjerrë me short një zëvendësues nga lista e përmendur në nenin 20 të Protokollit Shtesë 7 në të cilën anëtari në fjalë ishte përfshirë. Nëse anëtari në fjalë është zgjedhur nga palët në mosmarrëveshje, në përputhje me nenin 18(4) të Protokollit Shtesë 7, kryetari i panelit do të nxjerrë me short një zëvendësues nga listat e kombinuara të vendosura nga palët në mosmarrëveshje sipas nenit 20 të Protokollit Shtesë 7. Zëvendësuesi do të zgjidhet brenda 5 ditëve pune pas dorëzimit të kërkesës tek kryetari i panelit;

b) Nëse kryetari i panelit konstaton se anëtari në fjalë është në përputhje me Kodin e Sjelljes, anëtari do të mbetet në detyrë.

4. Kur njoftimi sipas paragrafit 2 lidhet me kryetarin e panelit, palët në mosmarrëveshje do të konsultohen dhe nëse janë dakord, shkarkojnë kryetarin dhe zgjedhin një zëvendësues, në përputhje me nenet 18(3) dhe 18(6) të Protokollit Shtesë 7. Nëse palët në mosmarrëveshje nuk arrijnë të bien dakord, brenda 10 ditëve nga njoftimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, Sekretariati i CEFTA-s, brenda 5 ditëve pune zgjedh me short një zëvendësues nga lista e përmendur në nenin 21 të Protokollit Shtesë 7, duke përjashtuar emrin e kryetarit aktual të panelit.

5. Sekretariati i CEFTA-s do të ftojë dhe do t'u japë një mundësi të arsyeshme përfaqësuesve të secilës palë në mosmarrëveshje që të jenë të pranishëm, me çdo mjet, kur të hidhet shorti.

6. Procedimi pezullohet për periudhën e nevojshme për të kryer procedurën e parashikuar në këtë dispozitë.

Neni 13 **Afatet kohore**

1. Të gjitha afatet kohore të përcaktuara në këtë shtojcë, do të numërohen në ditë kalendarike nga dita pas aktit ose faktit të cilit i referohen, përveç kur specifikohet ndryshe.

Kur, për shkak të zbatimit të nenit 1(8) të kësaj shtojce, një palë e cenuar merr një dokument në një datë të ndryshme nga data kur ai dokument merret nga ndonjë palë tjetër e cenuar, çdo periudhë kohe që llogaritet në bazë të datës së marrjes së atij dokumenti, do të llogaritet nga data e fundit e marrjes së atij dokumenti.

2. Afatet kohore të përcaktuara në këtë shtojcë do të rregullohen në përputhje me afatet e veçanta kohore të parashikuara për paraqitjen e një raporti të pajtueshmërisë së palëve në mosmarrëveshje, sipas nenit 31, pikat 4 dhe 5, të Protokollit Shtesë 7.

Neni 14 **Logjistika**

Sekretariati i CEFTA-s, në koordinim me palët në mosmarrëveshje dhe anëtarët e panelit, do të jetë përgjegjës për administrimin logjistik të procedurës, në veçanti organizimin e seancave dëgjimore dhe kërkesat administrative, në lidhje me anëtarët e panelit dhe asistentin e një paneli, si p.sh.: shpërblimin, shpenzimet dhe shtesat e udhëtimit, si dhe trajtimin e dokumenteve të ngarkuara në sistemin e komunikimit *online* në lidhje me procedimin.

Neni 15

Kostot

1. Secila palë e interesuar do të mbulojë shpenzimet e veta që rrjedhin nga pjesëmarrja në procedurën e panelit.

2. Shpenzimet në lidhje me procedurat, përkatësisht të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet e përgjithshme të bëra nga anëtarët e panelit dhe asistenti i panelit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të panelit dhe asistentit të panelit, do të llogariten dhe ndahen ndërmjet palëve të interesuara nga paneli, dhe të ofruara në një pjesë të dedikuar të raportit përfundimtar. Kjo pjesë e raportit përfundimtar do të jetë konfidenciale, përveç kur palët në mosmarrëveshje bien dakord ndryshe.

3. Paneli do të ndajë kostot lidhur me shpenzimet dhe kompensimin në bazë të kohës së shpenzuar për oponencat ligjore të suksesshme dhe të pasuksesshme të paraqitura nga pala kërkuese, duke marrë parasysh edhe pjesëmarrjen e palëve të treta. Pala kërkuese do të mbulojë shpenzimet, lidhur me shpenzimet dhe shpërblimin në raport me oponencat ligjore të pasuksesshme, pala përgjegjëse do t'i mbulojë shpenzimet, lidhur me shpenzimet dhe shpërblimin në raport me oponencat ligjore të suksesshme. Çdo palë e tretë do të mbulojë shpenzimet shtesë që i atribuohen nga paneli për pjesëmarrjen e saj.

4. Anëtarët e panelit dhe asistenti i panelit do të mbajnë një procesverbal dhe do të japin një raport përfundimtar të kohës së shpenzuar për procedurën dhe të shpenzimeve përkatëse. Regjistrimi i kohës do të pasqyrojë punën e kryer nga paneli, në lidhje me çdo oponencë ligjore të paraqitur nga pala kërkuese dhe do të përdoret për të ndarë kostot. Vendimi i panelit mbi ndarjen e kostove do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje, përveç nëse raporti i panelit apelohej, dhe në këtë rast vendimi mbi ndarjen e kostove do të jepet në vendimin e apelit, i cili do të jetë përfundimtar dhe detyrues.

5. Nëse palët në mosmarrëveshje arrijnë një zgjidhje të rënë dakord nga të dyja palët që çon në përfundimin e mosmarrëveshjes, kostot e lidhura me shpenzimet dhe shpërblimin e akumuluar deri në atë kohë do të mbulohen në mënyrë të barabartë nga palët në mosmarrëveshje, përveç nëse është rënë dakord ndryshe nga këto palë. Nëse një palë kërkuese vendos të tërheqë ankesën e saj, kostot e lidhura me shpenzimet dhe shpërblimin e akumuluar deri në atë kohë do të mbulohen plotësisht nga ajo palë kërkuese, përveç kur është rënë dakord ndryshe nga palët në mosmarrëveshje.

6. Tarifa ditore e anëtarëve të panelit do të jetë e barabartë me tarifën ditore që u akordohet anëtarëve të panelit në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Organizatën Botërore të Tregtisë. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë tarifën ditore në çdo kohë.

7. Tarifa për orë për asistentin e panelit nuk do të kalojë 50% të tarifës për orë të anëtarëve të panelit.

Neni 16

Fondi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Palët krijojnë Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, i cili do të jetë i ndarë nga fondet e tjera të CEFTA-s dhe fillimisht i nxjerrë nga Fondi i Hapur i CEFTA-s, dhe do të përdoret për financimin paraprak të mosmarrëveshjeve të rregulluara nga Protokolli Shtesë 7.

2. Sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 45 ditë pas hyrjes në fuqi të Protokollit Shtesë 7, Komiteti i Përbashkët do të përcaktojë shumën fillestare që do të vihet në dispozicion në Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në rast mosmarrëveshjeje. Burimet financiare do të transferohen nga Fondi i Hapur në Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, me kërkesën për krijimin e një paneli.

3. Burimet financiare për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të merren nga Sekretariati i CEFTA-s, nga Fondi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe do të kufizohen në aksionet individuale të secilës palë në mosmarrëveshje, të cilat do të jenë proporcionale me kontributet e tyre përkatëse në buxhetin e Sekretariatit të CEFTA-s.

4. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të rregullojë shumën e disponueshme në Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, duke e rritur ose zvogëluar atë sipas nevojës.

5. Çdo kontribut në Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve do të depozitohet në një llogari bankare të administruar nga Sekretariati i CEFTA-s. Sekretariati i CEFTA-s do të jetë përgjegjës për administrimin e Fondit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.

6. Fondi për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve do të përdoret për të paguar shpenzimet në lidhje me procedurën, siç përcaktohet në nenin 15 të kësaj shtojce.

7. Çdo tërheqje nga Fondi për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, siç llogaritet nga Sekretariati i CEFTA-s, do të plotësohet nga palët e interesuara, në përputhje me përcaktimin për ndarjen e kostove nga paneli në raportin përfundimtar ose në raportin e rishikimit të apelit. Pasi Fondi për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të jetë rimbushur, shumën do t'i kthehet Fondit të Hapur të CEFTA-s.

8. Nëse një palë nuk përmbush detyrimin e parashikuar në paragrafin 7 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga njoftimi përkatës nga Sekretariati i CEFTA-s, ajo do të pezullohet nga përdorimi i këtij Protokollit si palë kërkuese dhe palë e tretë deri në momentin që përmbush detyrimin përkatës. Pezullimi dhe përfundimi i pezullimit do t'i njoftohen Komitetit të Përbashkët nga Sekretariati i CEFTA-s.

9. Sekretariati i CEFTA-s do t'i dorëzojë Komitetit të Përbashkët një raport financiar mbi Fondin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve mbi baza vjetore.

Neni 17 Fushëveprimi

Rregullat e punës të përfshira në këtë shtojcë do të zbatohen për procedurat e panelit dhe, *mutatis mutandis*, për arbitrazhin e detyrueshëm për shqyrtim apeli.

SHTOJCA II KODI I SJELLJES

Neni 1 Përgjegjësitë e kandidatëve dhe anëtarëve të panelit

Çdo kandidat dhe anëtar i panelit duhet të shmangë parregullsitë dhe shfaqjen e parregullsive, duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm, duhet të shmangë konfliktet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të interesave, dhe të respektojë standardet e larta të sjelljes, në mënyrë që integriteti dhe paanshmëria e panelit të ruhen gjatë procedurave. Ish-anëtarët e panelit do të respektojnë detyrimet e përcaktuara në nenet 1 dhe 2, të kësaj shtojce.

Neni 2 Detyrimet e zbulimit

1. Përpara konfirmimit të përzgjedhjes së saj ose të tij si anëtar i panelit, një kandidat duhet të bëjë të ditur çdo interes, marrëdhënie ose çështje që mund të ndikojë në pavarësinë ose paanësinë e saj ose të tij, ose që mund të krijojë në mënyrë të arsyeshme një sjellje të papërshtatshme ose njëanshmëri në procedurë. Për këtë qëllim, një kandidat duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u ndërgjegjësuar për interesa, marrëdhënie dhe çështje të tilla.

2. Pavarësisht nga sa më sipër, kandidatët duhet të zbulojnë interesat, marrëdhëniet dhe çështjet e mëposhtme:

a) çdo interes financiar të kandidatit në: i. procedimin ose rezultatin e tij; dhe ii. një procedim administrativ, proces gjyqësor ose proces tjetër arbitrazhi që përfshin çështje që mund të vendosen në procedurën për të cilën kandidati është në shqyrtim;

b) çdo interes financiar i punëdhënësit, partnerit, bashkëpunëtorit të biznesit ose anëtarit të familjes së kandidatit, në: i. procedimin ose rezultatin e tij; dhe ii. një procedim administrativ, proces gjyqësor ose procedurë tjetër arbitrazhi që përfshin çështje që mund të vendosen në procedurën për të cilin kandidati është në shqyrtim;

c) çdo marrëdhënie financiare, biznesi, profesionale, familjare ose shoqërore ekzistuese, ose e kaluar me palët e interesuara në proces, ose avokatët e tyre, ose një marrëdhënie e tillë që përfshin punëdhënësin, partnerin, bashkëpunëtorin e biznesit ose anëtarin e familjes së kandidatit;

d) çdo dënim penal; dhe

e) mbrojtjen publike ose përfaqësimin ligjor apo tjetër në lidhje me një çështje që po shqyrtohet në procedurë ose që përfshin të njëjtat çështje.

3. Një kandidat ose anëtar i panelit do t'u komunikojë palëve në mosmarrëveshje çdo shkelje aktuale ose të mundshme të këtij Kodi të Sjelljes për shqyrtim.

4. Pasi të jetë zgjedhur, një anëtar i panelit do të vijojë të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u ndërgjegjësuar për interesat, marrëdhëniet ose çështjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe do t'i zbulojë ato. Detyrimi për zbulimin është një detyrë e vazhdueshme, e cila kërkon që një anëtar i panelit të zbulojë çdo interes, marrëdhënie ose çështje të tilla që mund të lindin gjatë të gjitha fazave të procedurës. Çdo zbulim do të bëhet duke informuar palët në mosmarrëveshje, me shkrim, për shqyrtimin e tyre.

Neni 3

Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të panelit

1. Një anëtar i panelit do të shmangë krijimin e një situate të njëanshmërisë dhe nuk do të ndikohet nga interesi vetjak, presioni i jashtëm, konsideratat politike, trazirat publike, besnikëria ndaj një pale ose frika nga kritika.

2. Një anëtar i panelit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nuk do të ketë asnjë detyrim ose nuk do të pranojë ndonjë përfitim që në çfarëdo mënyre do të ndërhynte, ose do të rezultonte se ndërhynte në kryerjen e duhur të detyrave të tij ose të saj.

3. Një anëtar i panelit nuk mund ta përdorë pozicionin e tij ose të saj brenda panelit për të ofruar ndonjë interes personal, ose privat dhe duhet të shmangë veprimet që mund të krijojnë përshtypjen se të tjerët janë në një pozicion të veçantë për të ndikuar tek ai ose ajo.

4. Një anëtar i panelit nuk mund të lejojë që marrëdhëniet ose përgjegjësitë financiare, të biznesit, profesionale, familjare, ose shoqërore të ndikojnë në sjelljen ose gjykimin e tij ose të saj.

5. Një anëtar i panelit do të shmangë hyrjen në çfarëdo marrëdhënie ose marrjen e ndonjë interesi financiar që mund të ndikojë në paanësinë e tij, ose që në mënyrë të arsyeshme mund të krijojë një sjellje të papërshtatshme ose njëanshmëri.

Neni 4

Detyrat e anëtarëve të panelit

1. Pas përzgjedhjes, një anëtar i panelit do të jetë i disponueshëm për të kryer dhe do t'i kryejë detyrat e tij tërësisht dhe me shpejtësi gjatë të gjithë rrjedhës së procedurës, me drejtësi dhe zotim.

2. Anëtari i panelit do të shqyrtojë vetëm çështjet e ngritura në procedurë dhe nuk do t'ia delegojë këtë detyrë asnjë personi tjetër.

3. Anëtari i panelit nuk do të angazhohet në komunikime *ex parte* në lidhje me procedurën.

Neni 5

Konfidencialiteti

1. Asnjë anëtar i panelit nuk do të zbulojë ose përdorë në asnjë kohë ndonjë informacion jopublik, në lidhje me një procedim ose të marrë një informacion të tillë gjatë një procedimi, me përjashtim të qëllimeve të atij procesi, dhe në asnjë rast nuk do të zbulojë ose përdorë ndonjë informacion të tillë për të marrë përfitime personale ose avantazh për të tjerët, ose për të ndikuar negativisht në interesin e të tjerëve.

2. Një anëtar i panelit nuk do të zbulojë një raport të ndërmjetëm, raport përfundimtar ose raport të shqyrtimit të apelit, ose pjesë të tij, përpara publikimit përkatës.

3. Asnjë anëtar i panelit në asnjë kohë nuk do të zbulojë diskutimet e një paneli apo pikëpamjet e ndonjë anëtari të panelit.

Neni 6

Detyrimet e ish-anëtarëve të panelit

Të gjithë ish-anëtarët e panelit duhet të shmangin çdo veprim që mund të krijojë idenë se ata kanë qenë të njëanshëm në kryerjen e detyrave të tyre ose se kanë nxjerrë ndonjë avantazh nga rezultatet, përcaktimet ose vendimet e panelit.

Neni 7

Fushëveprimi

Detyrat dhe përgjegjësitë sipas këtij Kodi të Sjelljes zbatohen, *mutatis mutandis*, si për asistentin e një paneli, edhe për arbitrat e ngarkuar me arbitrazhin detyrues për shqyrtim apeli.

ADDITIONAL PROTOCOL 7 ON DISPUTE SETTLEMENT TO THE AGREEMENT ON AMENDMENT AND ACCESSION TO THE CENTRAL EUROPEAN FREE TRADE AGREEMENT

Preamble

The Parties to the Agreement on Amendment of and Accession to the Central European Free Trade Agreement (CEFTA):

1. Considering Annex 1 to the Agreement on Amendment of and Accession to the Central European Free Trade Agreement (hereinafter referred to as "CEFTA 2006"), notably Articles 42 and 43 thereof, as well as Annex 8 on 'Appointment of the Mediator' and Annex 9 on 'Constitution and Functioning of the Arbitral Tribunal' thereto;
2. Having resolved to eliminate obstacles to trade within CEFTA and to progressively deepen the trade relations within the spirit of the General Evolutionary clause of the CEFTA 2006 contained in Article 45 thereof; and
3. Considering the Parties' interest in a more structured approach to consultations, mediation, and dispute resolution within CEFTA as foreseen by this Additional Protocol 7 (hereinafter referred to as this "Protocol");

have agreed as follows.

Section I: Initial Provisions

Article 1 Definitions

